

**SH.T. Albin Kurti**

Kryeministër i Republikës së Kosovës,  
Ndërtesa e Qeverisë, Sheshi "Nëna Tereza"  
Prishtinë, Kosovë

I nderuari Kryeminsitër,

Fillimisht, ju shprehim urimet tona për formimin e insitucioneve të reja dhe emërimin tuaj në krye të qeverisë. Me fillimin e punës së qeverisë, agjendat e vështira e sfiduese por edhe kërkesat e mëdha që po vinë kërkojnë një dinamikë të re të angazhimit institucional e politik. Çështja e dialogut me Serbinë vazhdon të rëndojë mbi institucionet dhe të shkaktojë mospajtime në skenën politike në vend. Ne besojmë fuqishëm se veprimet e qeverisë së re në lidhje me dialogun me Serbinë dhe çështjen e tarifës 100% ndaj mallrave me origjinë nga territori i Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës, duhet të jenë si vijonë.

1. Të supsendohet tarifa prej 100% për një periudhë prej 9 muajsh. Logjika dhe mundësia e rivendosjes së saj, fuqizon më shumë pozicionin e qeverisë së Kosovës.
2. Në ndërkohë të kërkohet me ngulm nga institucionet e BE-së, Franca, Gjermania dhe SHBA-të që të detyrojnë Serbinë të ndalojë fushatën ndaj Kosovës. Këto vende, poashtu të punojnë që tani me Serbinë dhe shtetet tjera për të siguruar mbështetj për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL, vitin tjetër.
3. Qeveria e Kosovës të kërkojë nga BE-ja (përfshirë edhe komisionin Evropian) që me hapa të shpejtë të punojë në implementimin e marrëveshjeve të arritura në lidhje me IBM-in, Lëvizjen e lirë, njohjen e tabelave të veturave dhe dokumenteve përcjellëse, implementimin e marrëveshjes për fito-sanitari, energjetikës etj, brenda një afati të caktuar kohor, më pak se periudha e suspendimit të tarifës.
4. Qeveria t'i mendoj me kujdes dhe ndërmarrë masa reciproke varësisht nga sjellja e Serbisë ndaj Kosovës, ndaj rrespektimit të marrëveshjeve, ligjeve dhe insitucioneve të Kosovës etj. Këto masa të vendosen nëse janë meritore si përgjigje ndaj veprimeve të Beogradit në të ardhmën.

Ne fuqishëm ju inkurajojmë të ndërmerni hapat e lartëshënuar por jo vetëm. Për çështjet e tarifës apo edhe masave të reciprocitetit, Grupi për Balkan është i gatshëm të organizoj një tryezë debatuese në ditët në vijim, me të gjithë aktorët institucional e jo qeveritar, të udhëhequr nga ju.

Grupi për Balkan së shpejti do të ju prezentoj një raport tejet të detajuar në lidhje me marrëveshjet e arritura në Bruksel, implementimin e tyre, dhe impaktin në praktikë.

Njëkohësisht, Grupi për Balkan, sikur edhe më herët, do të mbështesë fuqishëm qeverinë, insitucionet dhe partitë politike parlamentare, në qështjet e interesit nacional, përfshirë edhe procesin e dialogut me Serbinë.

Duke llogaritur fuqishëm në mbështetjen tuaj për këto procese, ju shprehim mirënjohjen tonë.

Sinqerisht,

Naim Rashiti, Drejtor Ekzekutiv  
Balkans Policy Research Group (BPRG)  
Tel" +3838 44 147 422  
Email: nrashiti@balkansgroup.org



Gjithashtu për:

1. Avdullah Hoti, Zëvendëskryeministër i Parë
2. Glauk Konjufca, Ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës
3. Luan Dalipi, Shef i Kabinetit të Kryeministrit

Qamil Hoxha 29/7,  
Prishtinë 10000, Kosovë  
office@balkansgroup.org  
+383 38 235 005